



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Proj. Prot. Prot. No
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	Data Datum Date
01	05-6607
-52-	23/10/2023
Prishtinë / Ia	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Ministrit / Ured Ministra / Office of the Minister

Nr.154/X/2023
Datë: 23.10.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerrë:

V E N D I M

- I.** Aprovohet Plani Strategjik dhe Plani i veprimit për Menaxhimin e mbeturinave medicinale 2024-2026.
- II.** Shtojcë e vendimit është Plani Strategjik dhe Plani i veprimit për Menaxhimin e mbaturinave medicinale 2024-2026.
- III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arbert Vitia
Ministër i Shëndetësisë



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh-së;



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministry of Health - Ministarstvo Zdravstva

PLANI STRATEGJIK PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE

2024 - 2026

Prishtinë

Tetor, 2023

PËRMBATJA

Lista e shkurtesave	3
Lista e tabelave.....	4
Lista e figurave	4
1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Hyrja.....	11
3. Metodologjia	12
4. Sfondi	13
4.1 Gjenerimi i MM.....	13
4.2 Praktikrat e Menaxhimit të Mbeturinave Medicinale.....	16
4.2.1 Trajtimi i mbeturinave brenda objekteve shëndetësore.....	16
4.2.2 Transportimi i mbeturinave të rrezikshme.....	19
4.3 Korniza ligjore dhe ajo institucionale	20
4.4 Korniza organizative.....	20
4.5 Aranzhimet financiare	22
4.5.1 Konsideratat shëndetësore dhe mjedisore	22
4.6 Analiza	24
5. Objektivat	29
5.1 Objektivi i Planit strategjik 1	30
5.2 Objektivi i Planit strategjik 2.....	32
5.3 Objektivi i Planit strategjik 3	33
6. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit.....	35
7. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i planit strategjik.....	38
Shtojca 1 - Plani i Veprimit.....	40
Shtojca 2 - Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	51
Shtojca 3 - Plani i Intervenimeve	51

Lista e shkurtesave

AT	Asistenca teknike
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
IKSH	Institucionet e kujdesit Shëndetësor
IKPSh	Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor
KPKI	Komisioni për Parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve
I-RAT	Mjet i individualizuar i vlerësimit të shpejtë
SMIMK	Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2021-2030)
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MMM	Menaxhimi i mbeturinave medicinale
MMMISH	Menaxhimi i mbeturinave medicinale në Institucionet Shëndetësore
MMJSh	Mbeturinat medicinale me jetëgjatësi të shkurtër
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PSO	Procedurat standarde operative
PMMM	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Medicinale
PPM	Pajisjet personale mbrojtëse
SP	Spitali i Përgjithshëm
ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
QKKTGJ	Qendra Kombetare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
ISH	Institucionet Shëndetësore
UA	Udhëzimi Administrativ
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Lista e tabelave

Tabela 1. Sasitë e mbeturinave medicinale infektive, të krijuara dhe të trajtuara në vitin 2021.	5
Tabela 2. Objektivat e planit të strategjisë dhe treguesit e rezultateve.....	7
Tabela 3. Kostot e zbatimit të planit strategjik.....	10
Tabela 4. Sasitë e MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara nga QKUK dhe spitalet e përgjithshme (Burimi: Të dhënat nga SP).....	13
Tabela 5. Sasitë totale të MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara në Kosovë.....	15
Tabela 6. MM të trajtuara në vitin 2021.....	15
Tabela 7. Analiza kritike e mangësive dhe reagimit strategjik.....	24
Tabela 8. Analiza e problemeve dhe formulimi i objektivave.....	29
Tabela 9. Struktura institucionale për monitorim dhe raportim.....	35
Tabela 10. Kostot e zbatimit të Planit të Veprimit, 2023-2025.....	38

Lista e figurave

Figura 1. Mangësitë kryesore të sistemit ekzistues për MMM.....	6
Figura 2. Ish të vizituara dhe vlerësuara.....	12
Figura 3. Ruajtja jo e duhur e mbeturinave infektive.....	16
Figura 4. Grirësi që nuk funksionon në një autoklavë që rezulton në mbeturina të trajtuara pjesërisht.....	17
Figura 5. Ruajtja e mbeturinave farmaceutike.....	18

1. Përmbledhje ekzekutive

Trajtimi aktual i mbeturinave medicinale në institucione shëndetësore paraqet sfidë të madhe dhe kërcënim mjedisor për Kosovën. Kjo është për shkak të mungesës dhe zbatimit të planeve të menaxhimit të mbeturinave medicinale në institucionet shëndetësore (ISh). Në përgjithësi, ka mungesë të zyrtarëve të caktuar dhe të kualifikuar, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave medicinale (MMM). Rrjedhimisht, të dhënat nuk mblidhen sistematikisht dhe nuk raportohen tek institucionet përgjegjëse, gjë që pengon vendimmarrjen e mirë.

Tabela e mëposhtme paraqet sasinë e mbeturinave medicinale infektive që janë krijuar dhe trajtuar në vitin 2021.

Tabela 1. Sasinë e mbeturinave medicinale infektive, të krijuara dhe të trajtuara në vitin 2021

MM e trajtuar	Mbeturinat medicinale infektive të trajtuara në 2021 (kg)	Mbeturinat medicinale infektive të krijuara në vitin 2021 (kg)	Lloji i ISh
Autoklava në 8 SP	762,809	921,126	Spitalet publike
Princi	30,225	60,095	IKPSh
MET BAT	12,300	50,676	Spitalet private
EnvriCon	10,000	70,990	ISh të tjera private
Totali	815,334	1,102,887	Totali

Përfundimi është se vetëm rreth 74% e totalit të MM të gjeneruara në vitin 2021 është trajtuar në mënyrë të sigurtë në instalimet e licencuara. Ndërsa destinacioni përfundimtar i pjesës së mbetur prej 26% nuk është përcaktuar, ekziston një probabilitet i lartë që këto mbeturina infektive dhe të mprehta të përfundojnë në deponi për mbeturinat e ngurta komunale. Kjo paraqet shqetësime serioze për shëndetin dhe mjedisin.

Figura më poshtë tregon përmbledhjen e mangësive kryesore në menaxhimin e mbeturinave medicinale brenda vendit.

Mbeturina infektive dhe të mprehta	<ul style="list-style-type: none"> • 26% e këtyre mbeturinave nuk grumbullohen • pajisjet e trajtimit të mbeturinave kanë arritur fundin e jetëgjatësisë së tyre
Mbeturinat farmaceutike	<ul style="list-style-type: none"> • mungesa e depove qendrore • nuk ka inventar të llojit dhe vëllimit të këtyre mbeturinave
Mbeturinat patologjike	<ul style="list-style-type: none"> • mungesa e etiketimit të duhur gjatë grumbullimit të veçantë
Mbeturinat kimike	<ul style="list-style-type: none"> • jo të ndara si të tilla • mungesa e objektit të licencuar për ruajtje dhe trajtim/depozitim të sigurt
Transporti i mbeturinave infektive	<ul style="list-style-type: none"> • nuk kryhet nga operatorë të licencuar • nuk ndjek standardet ndërkombëtare
Korniza ligjore dhe institucionale	<ul style="list-style-type: none"> • përgjegjësitë për MM kërkojnë një shkallë bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet akterëve
Aspektet organizative	<ul style="list-style-type: none"> • nuk ka zyrtarë përgjegjës të mbetjeve në IKSh dhe pajisjet janë të vjetruara • stafi nuk është i trajnuar rregullisht për MMM
Aspektet financiare	<ul style="list-style-type: none"> • buxhete të pamjaftueshme për MMM, të cilat çojnë në monitorim dhe kontroll të parregullt • prodhuesit e vegjël nuk paguajnë për shërbimet e MMM

Figura 1. Mangësitë kryesore të sistemit ekzistues për MMM

Plani Strategjik paraqet qasjen e Qeverisë për të përmirësuar MMM të sigurt në Kosovë.

- Plani Strategjik synon të adresoj mangësitë dhe kufizimet aktuale brenda sektorit të MMM, duke vendosur dhe realizuar tri Objektiva të planit Strategjik. Objektivat Strategjike dhe specifike të këtij Plani janë përcaktuar nëpërmjet një analize të problemeve dhe shkaqeve të tyre.

Tabela e mëposhtme paraqet Objektivat strategjike dhe specifike të identifikuara si dhe treguesit e rezultateve.

Tabela 2. Objektivat strategjike, specifike dhe treguesit e rezultateve

Objektivi i planit strategjik	Objektivat specifike	Treguesit e rezultateve
Objektivi i planit strategjik 1. Standardizimi i procedurave për menaxhimin e mbeturinave medicinale brenda institucioneve shëndetësore	Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i kornizës për menaxhimin e mbeturinave medicinale në institucionet shëndetësore në vend	Përqindja e ISH-ve që shfaqin përputhshmëri të shtuar me kornizën ligjore dhe procedurale të MMM. Gjendja fillestare: 45% në vitin 2021 Synimi: 80% në vitin 2025; 100% në vitin 2030
	Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i trajtimit të mbeturinave medicinale brenda institucioneve shëndetësore	Përqindja e ISH-ve publike që shfaqin trajtim të përmirësuar dhe lehtësira për menaxhimin e MM Gjendja fillestare: 45% in 2021 Synimi: 80% in 2025; 90% in 2030 Përqindja e ISh-ve private që shfaqin trajtim të përmirësuar dhe lehtësira për menaxhimin e MM Gjendja fillestare: 73% in 2021 Synimi: 80% in 2025; 90% in 2030
Objektivi i planit strategjik 2. Zhvillimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe infrastrukturës së sigurt për menaxhimin e mbeturinave medicinale në sektorin e shëndetësisë	Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i trajtimit të mbeturinave medicinale infektive dhe të mprehta	Përqindja e mbeturinave medicinale infektive dhe të mprehta që trajtohen dhe asgjësohen në mënyrë të sigurt. Gjendja fillestare: 74% në vitin 2021 Synimi: 90% në vitin 2025; 100% në vitin 2030

	Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i transportit të mbeturinave medicinale infektive	Treguesi: Përqindja e mbeturinave medicinale infektive të transportuara në përputhje me kërkesat ligjore Gjendja fillestare: 20% në vitin 2021 Synimi: 90% në vitin 2025; 100% në vitin 2030
	Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i ruajtjes qendrore të mbeturinave farmaceutike	Përqindja e mbeturinave farmaceutike të përfshira në objektet e duhura të centralizuara të ruajtjes Gjendja fillestare: 0% në vitin 2021 Synimi: 80% në vitin 2025; 100% në vitin 2030
Objektivi i planit strategjik 3. Forcimi i kapaciteteve brenda sektorit të për MMM	Objektivi specifik 3.1: Forcimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve profesionale	Përqindja e stafit në ISH (mjekësore dhe sanitare) që i janë nënshtruar trajnimeve të MMM në ISH në 12 muajt e mëparshëm Gjendja fillestare: 0 në vitin 2021 Synimi: 360 në vitin 2025; 504 në vitin 2030
	Objektivi specifik 3.2: Forcimi i kapaciteteve monitoruese dhe zbatuese	Numri i inspektimeve të koordinuara të IKSh-ve të kryera gjatë një periudhe 12 mujore Gjendja fillestare: 8 në vitin 2021 Synimi: 20 në vitin 2025; 40 në vitin 2030

Aktivitetet kryesore që do të mbështesin zbatimin e Objektivave Strategjike dhe Specifike përfshijnë:

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial përmes krijimit të Njesisë së Koordinimit të MMM dhe emërimit të koordinatorit
- Zhvillimi dhe zbatimi i planeve gjithëpërfshirëse të menaxhimit të MM në nivel spitalor
- Zhvillimi i një pakoje të procedurave standarde të operimit për trajtimin e MM
- Krijimi i një Komiteti Funkcional të Parandalimit të Infeksionit (KPI) - për të shqyrtuar të gjitha çështjet e MMMISH
- Ish të mëdha të emërojnë një anëtar të lartë të stafit si Menaxher të Mbeturinave - i cili duhet të jetë pjesë e KPI
- Prokurimi i një pajisje të standardizuar të mbeturinave dhe pajisje personale mbrojtëse (PPM) bazuar në vlerësimin e nevojave
- Përfshirja e menaxhimit të mbeturinave kimike në sistemin MM në sektorin shëndetësor
- Krijimi i sistemit standard të grumbullimit dhe trajtimit/depozitimit për mbeturinat farmaceutike
- Zëvendësimi i autoklavave të vjetruara me ato të reja
- Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese të objekteve të trajtimit në Spitalet e Përgjithshme (SP-të)
- Përgatitja e materialit trajnues dhe realizimi i trajnimit kombëtar të MMM për trajnerët (TiT) për të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor
- Institucionalizimi i MMM me përfshirjen e çështjeve të MMM në kurrikulën e shkollave të mjekësisë dhe universiteteve si dhe vendosjen e sistemit të certifikimit për menaxherët e mbeturinave në spitale.
- Sigurimi i burimeve njerëzore për të rritur numrin e inspektimeve për të promovuar zbatimin e standardeve për MMM.

Plani i veprimit ka të bëjë me planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për përmirësimin e trajtimit të MM në kuadër të ISh.

Financimi i Planit të Veprimit është si më poshtë:

Tabela 3. Kostot e zbatimit të Planit strategjik

Objektivat strategjike	2024	2025	2026	Total
Objektivi strategjik 1: Standardizimi i procedurave për menaxhimin e mbeturinave brenda sektorit të kujdesit shëndetësor	186,020	612,000	720,640	1,518,660
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe infrastrukturës së sigurt për menaxhimin e mbeturinave në sektorin e kujdesit shëndetësor	53,800	669,000	2,090,000	2,812,800
Objektivi strategjik 3: Fuqizimi i kapaciteteve brenda sektorit të MMM	31,000	0	0	31,000
Gjithsej	270,820	1,281,000	2,810,640	4,362,460

2. Hyrja

Menaxhimi i mbeturinave medicinale në institucionet shëndetësore (MMMISH) është mbi të gjitha një çështje menaxhimi përpara se të jetë një çështje teknike dhe për këtë arsye suksesi i tij varet tërësisht nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira. Menaxhimi i mbeturinave medicinale (MMM) është çështje që trajtohet si nga pikëpamja e shëndetit publik ashtu edhe nga pikëpamja mjedisore dhe për këtë arsye ka nevojë për një qasje ndërsektoriale.

Trajtimi aktual i MM paraqet sfidë të madhe dhe kërcënim mjedisor për Kosovën. Kjo është për shkak të një numri faktorësh të ndërlidhur, duke përfshirë: dështimin për të përgatitur ose për t'iu përmbajtur planeve të menaxhimit të mbeturinave (PMMM) brenda institucioneve shëndetësore (ISh); mungesa e stafit të caktuar dhe të kualifikuar përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave medicinale (MMM); dështim në mbledhjen dhe raportimin sistematik të të dhënave përkatëse tek institucionet përgjegjëse, gjë që pengon vendimmarrjen e mirë. Më e rëndësishmja, aktualisht një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave infektive dhe të mprehta ikën nga sistemet e veçanta të grumbullimit dhe hyjnë në rrjedhat e mbeturinave komunale - gjë që paraqet shqetësim serioz shëndetësor dhe mjedisor.

KY Plan strategjik mbështet zbatimin e Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (SKMIM / 2021-2030) dhe Planit të Veprimit (2021-2023). SKMIM i konsideron mbeturinat medicinale si mbeturina me prioritet të lartë dhe rrjedhimisht edhe menaxhimin e tyre të duhur me një prioritet të lartë.

SKMIM parashikon që të zhvillohen dhe miratohen procedura standarde të operimit (PSO) për MMMISH, me fokus ndarjen në burim të llojeve të mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet garantimit që gjeneruesit e MM të kenë qasje të arsyeshme në sistemet e menaxhimit profesional.

Për të përmirësuar MMM në të gjitha nivelet, SKMIM parashikon që të përgatitet një Plan strategjik për MMM për të mundësuar zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit.

3. Metodologjia

Plani strategjik për MMM është hartuar nga grupi punues i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë (MSh). Gjatë procesit është ofruar asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit nga Agjencia Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ*) dhe ekspert vendor nga Zyra regjionale e OBSH-së në Prishtinë.

Gjatë hartimit të dokumentit është bërë grumbullimi i të dhënave, rishikimi dhe analiza e problemeve, identifikimi i opsioneve dhe analiza e ndërhyrjeve të mundshme, përcaktimi i objektivave për zbatimin e Planit Strategjik, hartimi i Planit të veprimit si dhe konsultimet me palët e interesit gjatë gjithë procesit.

Të dhënat u grumbulluan kryesisht duke rishikuar raportet e kaluara, si dhe duke mbledhur statistika kombëtare dhe të dhëna administrative në dispozicion. Burimi kryesor i mbledhjes së të dhënave është bërë nga vizitat aktuale në 56 ISH nga konsulentët e angazhuar gjatë procesit.

Figura më poshtë paraqet numrin dhe llojin e ISH të zgjedhur dhe të vizituar.




Figura 2. ISH të vizituara dhe vlerësuara

“Mjeti i Individualizuar i Vlerësimit të Shpejtë” (I-RAT) i njohur ndërkombëtarisht u përdor për të marrë një tregues fillestar të nivelit të MMM në spitalet publike dhe private. I-RAT rezultoi në një rezultat të përgjithshëm që u përdor nga MSh për të vlerësuar ISH me qëllim të

prioritizimit të ndërhyrjeve. Gjithashtu, pyetësorët u përgatitën dhe u dërguan në një numër të madh të ISh-ve private (spitale, ambulanca, poliklinika, laboratorë dhe kabinete). Përgjigjet u përdorën për të vendosur më tej bazën për MMM në vend. Një anketë dyjavore u krye për të vlerësuar sasi të MM të gjeneruara nga institucionet e kujdesit parësor shëndetësor përmes inspektimit fizik dhe peshimit të mbeturinave. Kjo anketë është realizuar me mbështetjen e Komunes së Prishtinës dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë (QKMF).

4. Sfondi

Vlerësimi i detajuar i situatës aktuale është përgatitur si një raport shtesë (Raporti i Vlerësimit), i cili i bashkëngjitet këtij Plani (Shtojca 1). Nën-seksionet e mëposhtme ofrojnë përmbledhje të çështjeve kryesore, të mjaftueshme për të identifikuar mangësitë dhe për të përcaktuar formulimin e objektivave strategjike.

4.1 Gjenerimi i MM

Të dhënat për gjenerimin e mbeturinave medicinale aktualisht nuk raportohen në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM). Të dhënat e disponueshme në AKMM lidhen vetëm me mbeturinat e trajtuara me autoklavë në spitalet e përgjithshme (SP). Në vitin 2021, janë trajtuar 762 810 kg MM infektive në vend. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe përgatitjes së dokumentit, janë mbledhur të dhëna shtesë.

Tabela më poshtë paraqet sasi të MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara nga ISh të nivelit dytësor dhe tretësor në Kosovë.

Tabela 4. Sasi të MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara nga QKUK dhe spitalet e përgjithshme (Burimi: Të dhënat nga SP)

ISh dytësore dhe tretësore në Kosovë	MM të trajtuara (kg)		
	2019	2020	2021
Qendra Klinike Universitare e Kosovës	421,511	456,166	474,335
QKUK	367,689	404,741	424,871
QKMF	10,000	5,200	0
Dializa	43,559	46,078	49,326
IKSh private	263	147	138
Spitali i Përgjithshëm - Prizren	96,659	96,861	96,289
SP - Prizren	19,075	19,262	16,868

QKMF	1,986	1,797	2,751
Dializa	74,550	75,343	76,180
Ish private	607	332	363
Instituti i Shëndetit Publik	440	126	126
Spitali i Përgjithshëm - Mitrovicë	85,316	68,360	67,174
SP - Mitrovicë	21,287	16,998	18,341
QKMF	ND	ND	13,251
Dializa	63,861	50,994	35,582
Ish private	167	368	ND

Për të vlerësuar sasinë e MM të gjeneruara nga Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor (IKPSh), në vitin 2022 është realizuar një anketë në Ish të përzgjedhura. Kjo anketë është realizuar me mbështetjen e Komunës së Prishtinës dhe QKMF-së në Prishtinë. Është vlerësuar se gjenerimi mesatar i MM për pacient ambulator në IKPSh është rreth 15g (0.0152 kg/pacient ambulator).

Për sa i përket shkallës së zënies, numrit të shtretërve dhe sasive të raportuara të MM, të dhënat nga spitalet private tregojnë një normë mesatare të gjenerimit të MM prej 0,042 kg për shtrat të zënë. Në të njëjtën kohë, të dhënat nga spitalet publike tregojnë shkallën mesatare të gjenerimit të MM prej 0,52 kg për shtrat të zënë, që është shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹

Tabela më poshtë paraqet sasinë totale të vlerësuar të MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara në vend në vitin 2021, bazuar në normat mesatare të llogaritura të gjenerimit dhe numrin e pacientëve ambulatorë dhe shtretërve/normat e zënies në 2021.

¹ UNEP, Përmbledhje e Teknologjive për Trajtimin/Shkatërrimin e Mbeturinave të Kujdesit Shëndetësor, 2012:

- Spitali: 0,5 kg/krevat dhe ditë
- Klinika: 0,07 kg/pacient dhe ditë
- Njësia bazë shëndetësore: 0,01 kg/pacient dhe ditë

Tabela 5. Sasi të totale të MM infektive dhe të mprehta të gjeneruara në Kosovë

Lloji i ISh	Kg, 2021
Spitalet publike	921,126
IKPSh	60,095
Spitalet private	50,676
ISh të tjera private	70,990
Totali	1,102,887

Bazuar në këtë përlogaritje 1,102,887 kg mbeturina infektive dhe të mprehta janë gjeneruar në vend në vitin 2021. Si krahasim, të dhënat nga AKMM dhe kompanitë private të trajtimit të mbeturinave tregojnë se sasi të trajtuara të mbeturinave infektive dhe të mprehta në vitin 2021 ishin 815,335 kg, siç shihet nga tabela më poshtë.

Tabela 6. MM të trajtuara në vitin 2021

MM e trajtuara	Mbeturinat farmaceutike (kg)	Mbeturinat infektive (kg)
8 Spitale të përgjithshme	-	762,809
Princi	54,133	30,225
MET BAT	96,260	12,300
EnvriCon	-	10,000
Totali	150,393	815,334

Përfundimi është se vetëm rreth 74% e totalit të MM të gjeneruar në vitin 2021 është trajtuar në mënyrë të sigurt në instalimet e licencuara. Nuk dihet fati i pjesës së mbetur prej 26%, por ka shumë gjasa që këto mbeturina infektive dhe të mprehta të përfundojnë në deponitë e mbeturinave të ngurta komunale. Kjo paraqet shqetësime serioze për shëndetin dhe mjedisin.

Të dhënat e gjenerimit të mbeturinave të tjera të rrezikshme si mbeturinat kimike dhe mbeturinat radioaktive të krijuara në objektet shëndetësore nuk janë të disponueshme dhe nuk mund të mblidhen.

4.2 Praktikrat e Menaxhimit të Mbeturinave Medicinale

4.2.1 Trajtimi i mbeturinave brenda objekteve shëndetësore

Mbeturinat infektive dhe të mprehta

Mbeturinat infektive përgjithësisht ndahen dhe paktohen në shporta me veshje plastike - megjithëse ngjyra e qeseve nuk është e standardizuar. Shportat me pedale ose kontejnerët me kapak përdoren rrallë në ISh. Mbeturinat e mprehta ndahen në kontejnerë të mbrojtur nga shpimi - në shumicën e rasteve me vëllim 10 litërsh. Meqenëse kontejnerët e mprehtë standard 10 litërsh nuk janë të përshtatshëm për departamentet e hemodializës pasi sistemet e infuzionit me gjilpëra janë shumë të mëdha, përdoren alternativa si kuti kartoni ose shishe të mëdha uji bosh ose shporta me qese të rreshtuara.

Vendet e ruajtjes për mbeturinat infektive dhe të mprehta në SP janë të disponueshme, të



Figura 3. Ruajtja jo e duhur e mbeturinave infektive

mbyllura, të kyçura dhe të ajrosura ose të ftohura. Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor (IKPSh), megjithatë, nuk kanë një dhomë të veçantë për ruajtjen e mbeturinave infektive dhe të mprehta. Pra, mbeturinat shpesh ruhen në vende të papërshtatshme si tualetet publike në pritje të grumbullimit, gjë që nuk ndodh mjaft shpesh.

Mbeturinat infektive dhe të mprehta trajtohen në tetë objekte publike dhe tri private të trajtimit të mbeturinave.

Të gjitha objektet janë të licencuara për operacione të tilla.

Ambientet publike të trajtimit të mbeturinave janë ngjitur pranë spitaleve të përgjithshme. Gjatë funksionimit të autoklavave, efikasiteti i ventilimit është i pamjaftueshëm; dhomat e magazinimit janë shumë të vogla. Për shkak të kufizimeve të madhësisë së zyrës, operatorët shpesh vendosin tavolina, karrige dhe divane në dhomën e trajtimit të mbeturinave, e cila konsiderohet si një zonë me rrezik të lartë për shkak të mbeturinave infektive që trajtohen këtu.

Manualët e mbeturinave ose procedurat standarde të operimit (PSO) nuk janë të disponueshme. Në disa objekte janë aplikuar postera që tregojnë skemën e ndarjes së mbeturinave infektive, të mprehta dhe të përgjithshme, por informacioni i paraqitur është i vjetruar.

Të gjitha autoklavat publike të disponueshme në SP po i afrohen fundit të jetëgjatësisë së tyre funksionale. Shumica e tyre janë prokuruar më shumë se 10 vjet më parë. Vëzhgimet treguan se mbeturinat e trajtuara ndonjëherë nuk ishin copëtuar siç duhet - duke treguar se njësisia e macerimit po funksiononte keq (një problem i zakonshëm me vjetrimin e autoklavave pasi

tehet bëhen gjithnjë e më monotone). Ky është potencialisht shqetësim serioz pasi kjo do të thotë se nuk do të ketë ndodhur sterilizimi i plotë, duke e bërë materialin ende të rrezikshëm.



Figura 4. Grirësi që nuk funksionon në një autoklavë që rezulton në mbeturina të trajtuara pjesërisht

Më tej, u vu re se shumë nga gjilpërat nuk u shkatërruan, kështu që rreziku i lëndimit nga gjilpëra dhe infeksioni mbetet serioz.

Për më tepër, autoklavat e mbeturinave nuk janë vërtetuar apo testuar rregullisht për efikasitetin e tyre për të vërtetuar se procesi i dekontaminimit të mbeturinave infektive është realizuar. Kjo duhet të bëhet nga një organ i pavarur.

Mbeturinat patologjike

Mbeturinat patologjike në sektorin e shëndetësisë janë placenta dhe fetuset, pjesët e marra për analiza, pjesët e amputuara të trupit të njeriut dhe organet e tjera të hequra me operacion dhe qeset me gjak dhe produktet e gjakut. Shumica e mbeturinave patologjike krijohen në maternitete (placenta). Këto mbeturina janë të paketuara në qese plastike të mbeturinave ose kontejnerë plastikë dhe etiketohen si “mbeturinat e placentës”. Një sfond i verdhë ose i kuq me një shirit të zi të paketimit, siç kërkohet me ligj²³, nuk aplikohet. Mbeturinat më së shumti ruhen në ngrirës (*freezer*). Mbeturinat patologjike grumbullohen nga operatorë të licencuar sipas kërkesës. Aktualisht mbeturinat patologjike groposen në vende të caktuara, pasi dezinfektohen me gëlçere ose digjen.

Qeset me gjak dhe produkte të gjakut i nënshtrohen trajtimit si mbetje potencialisht infektive duke përdorur sterilizimin me avull (në autoklav).

Mbeturinat farmaceutike

Në përputhje me UA për trajtimin e mbeturinave nga produktet mjekësore (10/2015) mbeturinat nga produktet mjekësore konsiderohen gjithmonë si të rrezikshme. Ato përfshijnë: medikamente citotoksike dhe citostatike ose farmaceutikë që përmbajnë përbërës që janë toksikë, reaktivë, të ndezshëm ose korroziv në natyrë. Disa produkte farmaceutike duhet të parandalohen nga hyrja në burimet e ujit si hormonet dhe antibiotikët. Farmaceutikë të tjerë duhet të hidhen nën monitorim të rreptë si narkotikët ose substancat psikotrope për të

² Udhëzim Administrativ për menaxhimin e mbeturinave medicinale-patologjike (13/2017)

³ Udhëzim Administrativ për menaxhimin e mbeturinave medicinale humane dhe veterinare (22/2013)

parandaluar përdorimin e paautorizuar. Prandaj, mbeturinat farmaceutike duhet të klasifikohen dhe dokumentohen siç duhet dhe trajtohen/deponohen bazuar në karakteristikat e tyre të rrezikshme.

Pas luftës, Kosova trashëgoi një numër të konsiderueshëm të barnave të skaduara nga donacionet nga ndihmat humanitare ndërkombëtare. Që atëherë, sasi të mëdha të mbeturinave farmaceutike janë ruajtur në vende të ndryshme në të gjithë vendin. Bazuar në vlerësimin e konsulentit, vlerësohet se rreth 1,870 m³ mbeturina farmaceutike ruhen aktualisht për trajtim të mëvonshëm.



Figura 5. Ruajtja e mbeturinave farmaceutike

Më shumë se 80% e këtyre mbeturinave deponohet në depon nacionale për mbeturina farmaceutike, që gjendet në depon qëndrore të substancave mjekësore të MSh-së në Prishtinë. Mbeturinat e deponuara këtu nuk janë të dokumentuara. Pjesa tjetër ruhet në spitale të përgjithshme dhe QKMF. QKMF-të po mbledhin dhe mbajnë mbeturinat nga QMF-të më të vogla. Trajtimi dhe asgjësimi i këtyre mbeturinave nuk kryhet.

Mbeturinat nga ilaçet citotoksike dhe citostatike të krijuara në Ish për trajtimin e

kancerit duhet të menaxhohen me kujdes maksimal dhe të asgjësohen veçmas nga klasat e tjera të mbeturinave. Ashpërsia e rreziqeve për punonjësit e kujdesit shëndetësor përgjegjës për trajtimin ose asgjësimin e mbeturinave gjenotoksike rregullohet nga një kombinim i vetë toksicitetit të substancës dhe shtrirjes dhe kohëzgjatjes së ekspozimit. Mungojnë pajisjet e duhura të ndarjes, mjetet e transportit dhe infrastruktura e ruajtjes së mbeturinave citotoksike dhe citostatike.

Mbeturinat kimike

Kimikatet që përbëhen ose përmbajnë substanca të rrezikshme dhe kimikate jo të rrezikshme duhet të dallohen, pasi kërkesat për ruajtjen, trajtimin dhe asgjësimin janë të ndryshme. Aktualisht, mbeturinat kimike të krijuara në sektorin e shëndetësisë nuk ndahen, ruhen, trajtohen apo asgjësohen si të tilla. Në përputhje me vlerësimin e OBSH-së, rreth 5% e mbeturinave të krijuara në institucionet e kujdesit shëndetësor përbëhen nga mbeturina kimike dhe radioaktive. Prandaj, mund të supozohet se mbeturinat kimike krijohen në Ish të Kosovës,

por nuk ndahen dhe trajtohen si të tilla. Gjithashtu mund të supozohet se mbeturinat kimike të lëngshme hidhen në sistemin e kanalizimit.

Në Kosovë, nuk ka objekt qendror të licencuar për deponimin e mbeturinave të rrezikshme dhe as një impiant të specializuar për trajtimin e mbeturinave kimike të rrezikshme.

Mbeturinat radioaktive

Brenda sektorit të shëndetësisë, mbeturinat mjekësore radioaktive prodhohen ose krijohen më së shpeshti nga teknologjitë e mjekësisë bërthamore, procedurat e rrezatimit (p.sh. imazhet bërthamore) ose opsione të tjera të diagnostikimit ose trajtimit onkologjik. Skanimet e tomografisë me emetim pozitron nuk janë përdorur ende në Republikën e Kosovës. Sektori i shëndetësisë po përdor kryesisht radionuklide me mbeturina me jetëgjatësi të shkurtër (MJS), të cilat kanë jetëgjatësi 100 ditë ose më pak. Në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare të ofruara nga "Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike" dhe rregulloret kombëtare, MJS ruhen në kontejnerë të sigurt me plumb për t'u prishur përpara asgjësimit. Koleksioni specifik i MJS për ruajtjen qendrore nuk është i nevojshëm. Në rastet kur duhet të përdoren materiale radioaktive të nivelit më të lartë, këto substanca importohen nga jashtë dhe mbeturinat e krijuara grumbullohen dhe eksportohen me miratimin dhe kontrollin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes nga Rrezatimi.

4.2.2 Transportimi i mbeturinave të rrezikshme

Nga pika e gjenerimit, mbeturinat zakonisht mblidhen dhe transportohen me dorë, përderisa qasja e rekomanduar është përdorimi i karrocave me rrota të etiketuara dhe të mbyllura, ose shportave të transportit.

Transporti i mbeturinave infektive dhe të mprehta në rrugët publike zakonisht kryhet me furgonë të mbyllur ose, në një rast, me autoambulancë të përshtatur. Kompanitë dhe objektet që transportojnë këto mbeturina të rrezikshme nëpërmjet rrugëve publike në objektet e trajtimit të mbeturinave nuk janë të licencuara, automjetet nuk janë të etiketuara dhe monitorimi nga autoritetet nuk kryhet.

Në përputhje me kornizën ligjore ekzistuese, transportimi i mbeturinave të rrezikshme, përfshirë MM të rrezikshme, duhet të regjistrohet dhe certifikohet nëpërmjet një regjistri të veçantë nga autoriteti përkatës. Dokumentet e transportit të sigurt "Fleta përcjellëse për transportin e mbeturinave të rrezikshme", të kërkuara me Udhëzimin Administrativ 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, nuk përdoren. Ekziston nevoja për të vendosur rregullore kombëtare për transportin e mallrave të rrezikshme, duke përfshirë mbeturinat, bazuar në marrëveshjen ndërkombëtare në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme përmes rrugës.

4.3 Korniza ligjore dhe ajo institucionale

Brenda Republikës së Kosovës, korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave është relativisht mirë e zhvilluar – me Ligjin për Mbeturina (Nr. 04/L-060/2012) që është ligji bazë i cili rregullon menaxhimin e të gjitha llojeve të mbeturinave, duke përfshirë MM. Megjithatë, ka një sërë mangësishë në strukturën dhe zbatimin e legjislacionit.

Udhëzimet Administrative (UA-të) në lidhje me mbeturinat e gjeneruara në sektorin e shëndetësisë janë pjesërisht kontradiktore dhe të vjetruara. Mungon një akt nënligjor për validimin dhe testimin e rregullt të autoklavave të mbeturinave për të vërtetuar efikasitetin e dekontaminimit. Korniza ligjore për transportin e mbeturinave të rrezikshme infektive, e cila klasifikohet si UN 3291 në përputhje me “Marrëveshjen për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme” (ADR), është e jo e plotë dhe e pazbatuar.

Përgjatë pjesëve primare të legjislacionit dhe UA-ve, ka shumë raste kur detyrat dhe përgjegjësitë që kanë të bëjnë me menaxhimin e MM, veçanërisht mbikëqyrjen, u janë caktuar më shumë se një subjekti dhe/ose kërkon një shkallë të lartë bashkëpunimi ndërmjet tyre. Në realitet, kjo duket se ndodh rrallë, kur komunikimi dhe koordinimi mes tyre është i dobët.

Sa i përket rolit të komunave, Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ua cakton qartë atyre përgjegjësinë për menaxhimin e mbeturinave komunale, por përjashton mbeturinat medicinale – ndërsa LIGJI NR. 04/L-125 për shëndetësi nuk e ka rregulluar çështjen e mbeturinave në kujdesin shëndetësor

4.4 Korniza organizative

Në përputhje me rekomandimet e OBSH-së, menaxherët e ISH-ve janë përgjegjës për t'u siguruar që ekziston një sistem i përshtatshëm i ndarjes, transportit dhe magazinimit dhe që i gjithë personeli t'i përmbahet procedurave të rregullta. Një person i lartë, përgjegjës duhet të caktohet për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe raportuar për MM.⁴

Megjithatë, në shumicën dërrmuese të ISH-ve, nuk është caktuar një person përgjegjës për MMM. Dhe, aty ku ekzistojnë, Këshillave për parandalim dhe kontrollë të infeksionet (KPKI) gjatë kujdesit shëndetësor nuk u është dhënë, as nuk është zbatuar gjithmonë përgjegjësia për menaxhimin e MM të rrezikshme. Mospaktimi i një anëtari të lartë të stafit përgjegjës për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave është konstatuar gjithashtu në të gjithë ISH-të private në vend. Duke qenë se nuk ka strukturë organizative për menaxhimin e MM, situata brenda institucioneve është në mënyrë të pashmangshme në kushte nën optimale.

⁴ OBSH, Menaxhimi i sigurt i mbeturinave nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor: Përmbledhje; 2017

Shërbimet e pastrimit brenda ISH-ve kryesisht kontrahohen nga jashtë, dhe ndërgjegjësimi dhe njohuritë e stafit janë të ulëta – gjë që shoqërohet nga një nivel i lartë i lëvizjes së stafit.

Stafi mjekësor dhe jomjekësor në institucione shëndetësore nuk është i trajnuar për MMM – kështu që përsëri, nivelet e njohurive dhe ndërgjegjësimit janë të ulëta. MMM në shumicën e rasteve, nuk është pjesë e ndonjë kurrikule trajnimit në institucionet shëndetësore, as në shkollat apo universitetet e mjekësisë. Për më tepër, spitalet nuk kryejnë trajnime për operatorët për magazinimin dhe trajtimin e mbeturinave infektive. Mosarritja e ISH-ve për të siguruar staf, trajnim, pajisje dhe objekte të mjaftueshme (PPM, kosha, kontejnerë, vende të magazinimit) do të thotë që shëndeti dhe siguria e personelit mjekësor dhe atij sanitar vihet në rrezik të panevojshëm dhe të papranueshëm.

Bazuar në Ligjin për Mbeturina, të gjitha ISH-të duhet të dorëzojnë në AKMM të dhëna për sasinë dhe llojin e MMM-ve të gjeneruara dhe të asgjësuara. AKMM-ja ka për detyrë të përgatisë raporte vjetore për këtë temë – por shumica e ISH-ve publike nuk i gjenerojnë dhe as nuk i ndajnë këto të dhëna – dhe kështu ndodh edhe me sektorin privat.

Në mbarë Kosovën, ka shumë agjenci dhe inspektorate qeveritare të ngarkuara me role për mbikëqyrjen e menaxhimit të MMM të rrezikshme. Pavarësisht këtij fakti, niveli i monitorimit dhe mbikëqyrjes së ofruar është larg nga optimalja, kryesisht për shkak të mungesës së qartësisë, konfuzionit dhe mbivendosjes institucionale. Kjo situatë përkeqësohet nga nivelet e dobëta të komunikimit brenda agjencive qeveritare – që do të thotë se niveli i kërkuar i bashkëpunimit nuk ekziston.

Kjo situatë e mungesës së qartësisë institucionale dhe konfuzionit rezultues dhe mbivendosjes së mandateve përkeqësohet nga niveli i pamjaftueshëm i financimit dhe mungesa e mbështetjes politike të nivelit të lartë dhe prioritizimit për këtë temë. Si pasojë, të gjitha inspektoratet janë të prekura nga një mungesë serioze e burimeve (njerëzore, teknike dhe financiare) – që do të thotë se nuk ka inspektorë të mjaftueshëm në terren dhe ata që ekzistojnë nuk kanë qasje në automjete të mjaftueshme.

Shumica e institucioneve kanë në dispozicion Planet e Menaxhimit të Mbeturinave (PMM) siç kërkohet me ligj. Zakonisht, PMM-të janë mjaft të shkurtra me informata të kufizuara dhe nuk përfshijnë riciklimin ose minimizimin e mbeturinave. Përveç kësaj, aty ku ekzistojnë, PMM-të nuk përditësohen çdo vit.

4.5 Aranzhimet financiare

Udhëzimi Administrativ (22/2013) për Menaxhimin e Mbeturinave Medicinale Humane dhe Veterinare detyron gjeneruesit e mëdhenjë të MMM të mbulojnë shpenzimet e menaxhimit dhe asgjësimit si dhe shpenzimet e shkaktuara në lidhje me dëmtimin e mjedisit apo njerëzve. Megjithatë, nuk e trajton çështjen se kush do të paguajë për aktivitete të tilla kur ato kanë të bëjnë me prodhues të vegjël (qendra shëndetësore familjare, farmaci, qendra rehabilitimi, klinika ambulatorë, shtëpi për përkujdesje ndaj të moshuarve, klinika stomatologjike, qendra për ushqyerje të kafshëve, sallone të akupunkturës, qendra tatuazhesh, klinika veterinare, etj.).

Në përgjithësi, buxhetet në dispozicion janë të pamjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat. Kjo manifestohet në mënyra të ndryshme, si mungesa e PPM-ve, trajnimeve, posterëve edukativë, kontejnerëve, objekteve të vjetruara të magazinimit ose teknologjive të vjetruara të asgjësimit siç janë autoklavat. Për më tepër, kufizimet buxhetore mendohet se kontribuojnë në akumulimin afatgjatë të kategorive specifike të MM-ve, siç janë mbeturinat farmaceutike.

Një pasojë tjetër serioze e dispozitave joadekuate financiare është se inspektoriatet e ndryshme të ministrive përkatëse janë të pamjaftueshme në numër dhe shpeshherë nuk kanë qasje në pajisjet bazë, siç janë automjetet. Si rezultat, niveli dhe shpeshtësia e mbikëqyrjes dhe zbatimit është nën optimale.

Çdo spitalit të përgjithshëm i kërkohet të përgatisë buxhetet e tij vjetore bazuar në standardet e përcaktuara nga MSh. Përdorimi i shablloneve të buxhetit siguron standardizimin e parashtrësive dhe ndihmon për të siguruar që fondet e disbursuara janë kryesisht në përputhje me kërkesat. Megjithatë, në kuadër të shabllonit të buxhetit, nuk ekziston një linjë e veçantë buxhetore për MMM, e cila nuk lejon nivelin e dëshiruar të transparencës, monitorimit të buxhetit apo planifikimit financiar.

4.5.1 Konsideratat shëndetësore dhe mjedisore

MM duhet të menaxhohen siç duhet në mënyrë që të minimizohen rreziqet shëndetësore nga ekspozimi ndaj rreziqeve të njohura si infeksionet, efektet toksike dhe lëndimet. Ndarja e pasigurtë dhe asgjësimi i papërshtatshëm i MM infektive në mbeturinat komunale paraqet rrezik për përhapjen e infeksioneve të stafit dhe popullit. Ekziston një shqetësim i veçantë në lidhje me infeksionin e virusit HIV dhe viruset e hepatitit B dhe C, për të cilat ka dëshmi të forta të transmetimit nga lëndimi nga gjilpërat e shiringave të kontaminuara nga gjaku i njeriut, gjë që mund të ndodhë kur mbeturinat e mprehta menaxhohen keq.⁵

⁵ OBSH 2014; Menaxhimi i sigurt i mbeturinave nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor. Botim i Dytë

Rreziqe të tjera të mundshme përfshijnë mikroorganizmat rezistente ndaj ilaçeve të cilat përhapen nga institucionet shëndetësore në mjedis. Në rastet kur ngarkesa e mbeturinave të rrezikshme hyn në mjedis, ajo mund të futet në ajër, në ujërat sipërfaqësore ose në ujërat nëntokësore dhe mund të udhëtojë në distanca të gjata në ajër. Në varësi të rrezikut, populli mund të helmohet dhe mjedisi të ndotet. Transporti i parregulluar i mbeturinave të rrezikshme në rrugët publike mund të shkaktojë rreziqe të mëdha për shëndetin dhe mjedisin – veçanërisht për shkak të aksidenteve ose sigurisë së papërshtatshme të ngarkimit.

Spektori shëndetësor është një kontribuues i konsiderueshëm në emetimet e gazeve, duke përbërë rreth 4-5% të emetimeve totale në nivel global.⁶ E vetëdijshme për mundësinë e zvogëlimit të emetimeve të tyre dhe dëmeve të lidhura me shëndetin dhe mjedisin, Kosova synon të reduktojë emetimet e gazrave serrë me 8,95 Mt ekuivalente të CO₂ deri në vitin 2030.⁷ Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave synon gjerësisht të reduktojë sasinë e burimeve natyrore që konsumohen duke ripërdorur, ricikluar ose rigjeneruar materialet sa më shumë herë që të jetë e mundur para se të arrijnë fundin e jetëgjatësisë së tyre. Gjithashtu siguron që gjenerimi i çdo mbeturine të jetë minimal dhe asgjësimi të bëhet në një mënyrë që redukton emetimet e gazrave serrë dhe, si rrjedhojë, dëmin mjedisor.

Për të krijuar një sistem të MMM i cili është i sigurt dhe i shëndoshë për mjedisin, përditësimi i kornizës ligjore dhe monitorimi i zbatimit të saj është një faktor vendimtar. Për më tepër, përgjegjësitë duhet të përcaktohen qartë, pajisjet adekuate dhe të mjaftueshme të mbeturinave duhet të jenë në dispozicion dhe autoritetet dhe stafi duhet të jenë të ditur dhe të vetëdijshëm.

⁶ Karliner J, Slotterback S, Boyd R, Ashby B, Steele K, Health care's climate footprint. Hoë the health sector contributes to the global climate crisis and opportunities for action. Health Care Without Harm, Reston, VA2019

⁷ <https://climatepromise.undp.org/ëhat-ëe-do/ëhere-ëe-ëork/kosovo>

4.6 Analiza

Tabela e mëposhtme liston disa nga çështjet më kritike me të cilat përballet sektori i menaxhimit të mbeturinave të kujdesit shëndetësor dhe reagimin strategjik që duhet të merret parasysh.

Tabela 7. Analiza kritike e mangësive dhe reagimit strategjik

Aspekti	Çështja kritike	Reagimi strategjik
Mbeturinat e përgjithshme	Mbeturinat që mund të riciklohen nuk ndahen nga mbeturinat e tjera të përgjithshme jo të rrezikshme	Planifikimi dhe krijimi i një sistemi riciklimi për objektet shëndetësore
Mbeturinat infektive dhe të mprehta	Ngjyra e thasëve nuk është e standardizuar	Standardizimi i grumbullimit të veçantë të MM-ve në përputhje me kërkesat ligjore
	Pajisje joadekuate për grumbullimin e veçantë dhe trajtimin e MM	Sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme për trajtimin e mbeturinave si PPM, kontejnerë për mbeturina të mprehta, kosha me pedale me madhësi dhe ngjyrë të përshtatshme
	Institucionet e KPSH-së nuk kanë dhomë të veçantë për magazinimin e mbeturinave infektive dhe të mprehta	Krijimi/caktimi i vendeve të sigurta të magazinimit për mbeturinat infektive dhe të mprehta
Mbeturinat patologjike	Ngjyra e thasëve nuk është e standardizuar	Standardizimi i grumbullimit të veçantë të MM në përputhje me kërkesat ligjore
Mbeturinat farmaceutike	Vëllime të tepërta të mbeturinave farmaceutike historike (mbi dhjetë vjeç) ruhen në farmacitë spitalore për një kohë të gjatë pa pasur në dispozicion një mjedis të përshtatshëm magazinimi - etiketimi dhe paketimi është i pamjaftueshëm	Planifikimi dhe zbatimi i vendeve të mbyllura dhe të sigurta të magazinimit për mbeturinat farmaceutike dhe krijimi i një sistemi të qartë të etiketimit
	Mungojnë pajisjet e duhura për ndarjen, mjetet e transportit dhe infrastruktura e magazinimit të mbeturinave citotoksike dhe citostatike	Zhvillimi i udhëzimeve për magazinimin dhe trajtimin e sigurt të materialeve citotoksike dhe gjenotoksike
	Platforma ose rrjeti për shkëmbimin e informacionit mbi farmaceutikët dhe	Krijimi i një platforme dhe rrjeti farmacish për të ofruar informata mbi

	kohëzgjatjen e përdorimit nuk është në dispozicion për t'u dhënë mundësinë e ofrimit të farmaceutikëve të cilët janë afër datës së skadimit objekteve të tjera me nevoja	kohëzgjatjen e përdorimit dhe për të reduktuar gjenerimin e mbeturinave farmaceutike
Mbeturinat kimike	Aktualisht, mbeturinat kimike të gjeneruara në sektorin e shëndetësisë nuk janë të ndara, të magazinuara brenda vendeve të gjenerimit.	Zhvillimi i një udhëzuesi të qartë për ndarjen, etiketimin, magazinimin dhe dokumentimin e mbeturinave kimike dhe sigurimi i kabineteve/objekteve të përkohshme të magazinimit në laboratorë
	Amalgama dentare që përmban merkur nuk ndahet por ajo grumbullohet dhe asgjësohet kudo si mbeturinë e rrezikshme	Zhvillimi i udhëzuesit për ndarjen dhe ruajtjen e amalgamës që përmban merkur dhe blerjen e ndarësit të amalgamës për dentistët në sektorin publik
Transporti i mbeturinave të rrezikshme	Mbeturinat brenda institucioneve shëndetësore transportohen pa pajisje apo automjete adekuate transportuese	Blerja dhe sigurimi i karrocave ose koshave të transportit të përshtatshëm të etiketuar dhe të mbyllur për sektorin publik
